

**EVELINA QIRJAKO**, Anëtare e Gjykatës së Lartë, ka lindur në Sarandë më 10 Prill 1967. Është diplomuar për drejtësi në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, në vitin 1989. Znj. Qirjako ka ushtruar funksionin e Këshilltares Ligjore pranë Zyrës së Këshillimit Ligjor Tiranë gjatë periudhës 1 Shtator 1989 deri më 31 Nëntor 1990. Në periudhën 1990-1999 ka ushtruar profesionin e Avokates dhe nga Qershor 1999 deri në Mars 2001 ka qenë Bashkëpunëtoresh (Associate) pranë Zyrës Ndërkombëtare Ligjore Tonucci. Nga viti 2001 deri në 2008 ka themeluar dhe ka drejtuar një nga zyrat më të njohura të avokatisë në Tiranë, “Qirjako” Law Office, me fushë ushtrimi në çështje civile. Znj. Qirjako ka qenë pedagoge e jashtme pranë Fakultetit të Drejtësisë nga 1994 -1996, në lëndën e Drejta e Detyrimeve, dhe që nga Tetor 2002 deri më sot është Arbitre pranë Arbitrazhit Gjyqësor të Shqipërisë. Ajo ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh, brenda dhe jashtë vendit, për të drejtën tregtare, të drejtat e njeriut, dhe ka ushtruar funksionin e Ekspertes Ligjore pranë Shkollës së Magjistraturës për ligjin “Për Shoqëritë Tregtare”. Znj. Qirjako është anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, si dhe nga viti 1992 Anëtare e Dhomës Ndërkombëtare të Avokatisë. Me dekretin nr.5793, datë 08.07.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, u emërua anëtare e Gjykatës së Lartë.